

Portal i Prindërve

Çelësi për një shëndet më të mirë të nxënësit/es



Qëndro i/e Informuar mbi Shëndetin e Fëmijës Suaj

Portali shëndetësor SNAP ju lidh me klinikën shëndetësore të shkollës së fëmijës tuaj për të përmirësuar në maksimum shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Meqenëse komunikimi është thelbësor për kujdesin parandalues, portali shëndetësor shpejton shkëmbimin e informacionit në një mënyrë të shpejtë, domethënëse dhe të sigurt. Me një qasje të përshtatshme 24-orëshe, nga kompjuteri apo telefoni juaj, mund të rishikoni dhe rifreskoni me lehtësi informacione kritike shëndetësore, të nënshkruani dhe të dërgoni elektronikisht formularë, të merrni rezultate analizash, të paraqisni rezultate vaksinash, të autorizoni porosi OTC, të ngarkoni dokumente mjekësore dhe shumë më tepër! Njoftimet automatike me email ju informojnë menjëherë, sapo informacioni i ri është i disponueshëm.

Transmetimi i koduar mbron të gjitha të dhënat nga ekspozimi dhe plotëson standardin më të lartë të sigurisë, duke mundësuar që informacioni shëndetësor të mbahet gjithnjë i sigurt dhe konfidencial.

Pikat Kryesore të Portalit të Shëndetit

- Hyrje e sigurt & transferim i koduar i të dhënave
- Formularë të thjeshtuar, me nënshkrim elektronik
- Përditësim i thjeshtë i informacionit shëndetësor, ndërkohë që shtohet apo ndryshon
- Ngarkim i këshillave, vizitave të mjekut, karta vaksinash, etj.
- Të kujtuarit për informacione të rëndësishme shëndetësore
- Ndarja e informacionit me ofrues të tjerë
- Mesazhe të drejtpërdrejta me klinikën shëndetësore
- Përqasje 24/7 në internet, nga çdo kompjuter/celular

Prisni një email nga @studentehr.com, që ju dërgon emrin tuaj të përdoruesit dhe fjalëkalimin.

